



Universiteti i Prizrenit

PROGRAMI MËSIMOR – SYLLABUS							
Niveli i studimeve	katëvjeçar	Programi	Gjuhë shqipe	Viti akademik	2021/22		
LËNDA	Letërsi e sotme shqipe – poezi						
Viti	IV	Statusi i lëndës	Obligative	Kodi		ECTS kredi	6
Semestri	VII						
Javët mësimore	15		Orët mësimore			Ligjërata	Ushtrime
						√	√
Metodologjia e mësimimit	Ligjërata, ushtrime – ekspikim dhe interpretim i teksteve, seminare, debate, prezentime						
Konsultime							
Mësimdhënësi	Prof.ass.dr. Vjollca Dibra Ibrahim			e-mail	vjollca.dibra@uni-prizren.com		
				Tel.	044 199487		
Asistenti	Fikret Ramadani			e-mail			
				Tel.			

Qëllimi studimor i lëndës	Përfitimet e studentit
<p>Lënda Letërsi e sotme shqipe (poezia), ka të bëjë me shtjellimin e lëndës lidhur me kushtet dhe rrethanat në të cilat u zhvillua kjo letërsi në poezi, shtrirja gjeografike që nga fillimet e kësaj periudhe (pas Luftës së Dytë botërore) e tutje. Bëhen përpjekje që të studiohet struktura e kësaj poezie, përkatësisht struktura e procesit të zhvillimit të saj gjatë kësaj periudhe kohore si dhe rezultatet që ka arritur përmes shikimit specifik të tekstit letrar.</p> <p>T'i pajisë studentët me njohuri të përgjithshme për kontekstin, për fazat, për prirjet, për strukturat, për vlerat dhe për autorët, veprat e të cilëve kanë luajtur rol përcaktues në zhvillimin e strukturës së letërsisë shqipe në harkun kohor nga pas Lufta e Dytë Botërore e deri në ditët e sotme. Gjithashtu do të bëhet përpjekje që studentët individualisht apo në grupe të hulumtojnë vetë dukuri, vepra e autorë përmes qasjes interaktive.</p>	<p>Të formojnë idenë për hartën (relievin) e përgjithshme të zhvillimeve letrare brenda hapësirës shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore e këtej.</p> <p>Gjatë zhvillimit të ligjëratave, ushtrimeve e konsultimeve si dhe në përfundim të kursit studentët do të kenë mundësinë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të fitojnë informacione dhe të demonstrojnë njohuri për poezinë e sotme shqipe. 2. Të tregojnë aftësi për lexime kritike si dhe për shkrime kritike – analitike. 3. Të përdorin me saktësi literaturën shkencore teoriko – letrare e historiko – letrare.

Metodologjia për realizimin e temave mësimore:			
<p>Në ligjërata do të përdoret metoda interaktive. Kështu studentët do të inkurajohen që t'i zhvillojnë shkathtësitë dhe njohuritë mësim-nxënies dhe të kompetencës në fushën e kërkimit dhe të studimit shkencor. Diskutimi i problemeve, stili i mësimdhënies, format e punës: frontale, grupore, individuale, të praktikës, seminarike, edhe ndonjë formë tjetër. Përveç ligjërava, ushtrimeve dhe eseve, do të bëhet edhe interpretimi i veprave nga ana e studentëve, të cilët do t'i lexojnë ato.</p>			
Kushtet për realizimin e temës mësimore:			
Laptop, projektor, prezentim etj.			
Mënyra e vlerësimit të studentit (në%)			
Vlerësimi i parë: 20 % / Vlerësimi i dytë 15 % Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10 % Vijimi i rregullt 5 % Provimi final 50%	Vlerësimi në %	Nota përfundimtare	
	100% - 91%	10 (dhjete)	
	90% - 81%	9 (nëntë)	
	80% - 71%	8 (tetë)	
	70% - 61%	7 (shtatë)	
	60% - 51%	6 (gjashtë)	
	50%	5 (pesë)	
Obligimet e studentit:			
Ligjërata Pjesëmarrja në ligjërata dhe përgatitja e seminareve dhe eseve janë obligative		Ushtrime Leximi dhe interpretimi i veprave të autorëve të ndryshëm	
Ngarkesa e studentit për lëndën			
Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej:
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	4	2	8
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet ,etj	1	4	4
Vërejtje: 1 ECTS kredi=25 orë angazhim,p.sh nëse lënda i ka 6 ECTS kredi student duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë		Ngarkesa totale:	151 orë 151:25=6.0 4 6 ECTS

Java	Ligjërata		Ushtrime	
1.	Tema	Orët	Tema	Orët
	Poezia e sotme shqipe– Përkufizime. Konteksti socio-politik dhe idetë letrare. Periodizimi sipas etapave.	3		2
2.	Poezia e Esad Mekulit	3		2
3.	Vepra poetike e Martin Camajt	3		2
4.	Poezia e Enver Gjerqekut	3		2
5.	Në kërkim të së resë Përpjekjet poetike në gjetjen e temave të reja Krijimtaria poetike e Ismail Kadaresë	3		2
6.	Krijimtaria poetike e Dritero Agollit	3		2
7.	Vleresimi i pare	3		2
8.	Poezia e Fatos Arapit	3		2

9.	Poezia e Din Mehmetit	3		2
10.	Poezia e Azem Shkrelit	3		2
11.	Poezia e Rrahman Dedajt	3		2
12.	Poezia e Ali Podrimjes	3		2
13.	Poezia e Xhevahir Spahiut	3		2
14.	Test II	3		2
15.	Poezia Shqipe e viteve 90	3		2

LITERATURA

1. Martin Camaj, *Lirika, Dukagjini, Pejë, 2000*
2. Rexhep Qosja, *Prej tipologjisë deri te periodizimi, Prishtinë, 1984.*
3. Agim Vinca, *Struktura e zhvillimit të poezisë së sotme shqipe (1945-1980), Rilindja, Prishtinë, 1985;*
4. Basri Capriqi, *Simboli dhe rivalët e tij*
5. Vjollca Dibra: *Mozaiku i jetës model i artit (Poetika e tregimeve të Anton Pashkut), Prishtinë 2009*
6. Bashkim Kucuku, *Antologji e poezisë bashkëkohore shqipe*
7. Roland Zisi, *Letërsi bashkëkohore shqipe –Naimi, Tiranë, 2015*
8. Poezia Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqipe*
9. Sabri Hamiti, *Studime letrare, AshAK*

Literatura shtese:

1. Librat me poezi të zgjedhura të kolanës Albatros të Rilindjes
2. Librat me poezi të zgjedhura të kolanës Kambana – Poezia e zgjedhur shqipe – Toena

VËREJTJE

Nuk do të ketë kurrfarë tolerime për “huazim” nga interneti apo kudo tjetër. Punimet e njejta apo të ngjajshme gjithashtu do të ndëshkohen. Rekomandohet që punimet që dorëzohen të jenë të shkruara me kompjuter.

Vërejtje për studentin:

Studentët duhet t’u përbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së dhe rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe këshilli mësimor
Studentët janë të obliguar që t’i vijojnë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Në procesin e mësimin kërkohet respektimi i rregullave të mirësjelljes: ardhja në kohën e caktuar, qetësia në mësim; ndalohet përdorimi i telefonave celularë.